

U D H Ë Z I M
Nr. 6, datë 18.6.2002

**PËR PLOTËSIMIN DHE SHPËRNDARJEN E TABELAVE TË REZULTATEVE NË
QENDRAT E VOTIMIT PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR DEPUTETË TË
DREJTPËRDREJTË NË ZONËN ZGJEDHORE NR.19 PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË
DATËS 7.7.2002**

Në mbështetje të nenit 106 dhe 107 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

1. Tabelat e rezultateve model 54, 65 plotësohen nga KQV-ja, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 106 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” manualin e këtyre komisioneve dhe shënimet udhëzuese të çdo tablele.

2. Me qëllim shmangien e konfuzionit në KQV dhe zhvillimin e procedurave të sakta dhe të shpejta, rekomandohet që, si rregull, anëtarëve të KQV-së, përfaqësuesve të subjekteve politike, apo kandidatëve, si dhe vëzhguesve vendas dhe të huaj që dëshirojnë të marrin një kopje të tabelave të rezultateve t’u jepet modeli 56 “Tabela e përgjithshme rezultateve”.

3. Në raste kur një anëtar i KQV-së, përfaqësues i një subjekti zgjedhor apo një vëzhgues ka kundërshtuar rezultatin e pasqyruar në tabelën model 54 dhe, për kundërshtimin, KQV-ja ka marrë një vendim të cilin ankuesi vazhdon ta kundërshtojë, në këtë rast apo në raste të ngjashme, kërkuesit i jepet një kopje e tabelës model 54.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.